



Bomberi shkodran Hamdi Salihi ka folur per ndeshjen e radhes per kualifikueset qe Shqiperia pergatitet te mbylle. “Eshte nje ndeshje e rendesishme per ne. Luajme perballe publikut dhe do te japim me te miren. Ky edicion ka qene i jashtezakonshem. Kam provuar emocionet me te medha te karrieres dhe na duhet ta mbyllim me entuziazem per ta rinisur me pas sic duhet. Persa i perket shqiptareve qe luajne per Zvicren, ata kane zgjedhur nje kombetare tjeter por ne na bejne krenar me performancat e tyre ne klubet e medha ku luajne”, ka thene Salihi.